

KUFIZIMET DHE PERSPEKTIVA E MARRËDHËNIEVE EKONOMIKE NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE SERBISË

Edison Jakurti
Dhjetor 2022



Forcat ekonomike vetëm nuk mund ta bëjnë atë që vullneti politik nuk do ta bëjë



Ndonëse është e vërtetë që marrëdhëniet ekonomike nuk mund ta zëvendësojnë vullnetin politik, i cili është i nevojshëm për t'i zgjidhur çështjet që kanë mbetur hapur mes dy vendeve, marrëdhëniet ekonomike nuk duhet hudhur poshtë si të papërdorshme



Një përqëndrim intensiv në progresin *brenda* vendit i cili reflekton në progresin *mes* vendeve, i ndërtuar në progresizëm ekonomik, përbën një platformë ku shanset për sukses janë më të mëdha



Një zhvendosje paradigmatiche nga *barazia në mundësi në drejtësi* dhe nga tregtia e *lirë* në tregtinë *fer* mund të hapë horizonte për nisma më të suksesshme të bashkëpunimit ekonomik në të ardhmen

Botuesi: Friedrich Ebert Stiftung, Rr. Pashko Vasa 23,
10000 Prishtina, Republika e Kosovës

Përgjegjës: Renè Schlee

Projekt Koordinator: Rudina Nallbani Hoxha

Autor: Edison Jakurti

Data: Dhjetor 2022

Dizajni: Milky Way Creative

Printimi: Studio Forma

Autori merr përgjegjësinë e plotë për përmbajtjen e botimit. Mendimet e shprehura nuk janë domosdoshmërisht ato të Friedrich Ebert Stiftung.

KUFIZIMET DHE PERSPEKTIVA E MARRËDHËNIEVE EKONOMIKE MES REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE SERBISË¹

1. Hyrje

Zhvillimi ekonomik shihet si një mjet për t'i shëruar ose së paku zbutur të metat e një vendi. Meqë politika e jashtme shpesh portretizohet si reflektim i zhvillimeve të brendshme, atëherë cila është fuqia e forcave ekonomike që përmes bashkëpunimit bilateral ose multilateral t'i shtendosin marrëdhëniet apo edhe t'i zgjidhin çështjet e hapura mes vendeve? Në kontekstin mes Republikës së Kosovës² dhe Serbisë përgjigja ndaj kësaj pyetjeje ka qenë më shpesh sipërfaqësore sesa analitike. Kur bëhet një analizë e kujdesshme e nismave të kaluara, së bashku me natyrën e mosmarrëveshjes kryesore, që është vetë subjektiviteti shtetëror, shpërfaqen kufizime të shumta. Mirëpo, një zhvendosje paradigmатike prej *barazisë në mundësi* tek *drejtësia* dhe prej tregtisë së *lirë* në tregti *fer*, dhe një përqëndrim i intensifikuar në progresin e *brendshëm*, me kusht që të ketë vullnet politik, mund të hapë horizonte që mundësojnë nisma më të suksesshme të bashkëpunimit ekonomik në të ardhmen.

¹ Versioni original i këtij shkrimi është në gjuhën angleze dhe në rast të çfarëdo paqartësie që mund të haset në këtë përkthim duhet referuar versionin original.

² Këtu e tutje referuar vetëm si Kosova.

2. Forcat ekonomike vetëm nuk mund ta bëjnë atë që vullneti politik nuk do ta bëjë

Niveli i zhvillimit ekonomik mund të jetë kyç në formësimin e klimës dhe orientimit politik brenda një vendi. Nëse e vendosim në një kontekst ndërkombëtar, sidomos kur kemi parasysh marrëdhëniet tregtare, një propozim i tillë mund të shihet edhe si një shteg i mundshëm për të zgjidhur konflikte dhe ndërtuar paqe mes vendeve – një tezë kjo e shtyer përpara nga Immanuel Kant-i në veprën e njohur *Paqja e Përhershme: Një Skicë Filozofike* të publikuar në shekullin e XVIII-të por që shpesh mbështetet edhe nga shumë ekonomistë ditëve të sotme. Në frymën e këtij argumenti, Thomas L. Friedman, në librin e tij *Lexusi dhe Pema e Ullirit: Të Kuptuarit e Globalizimit*, shkruante: “Nuk ka ndodhur që dy vende që kanë pasur McDonald's të kenë luftuar mes vete që prej kohës kur kanë pasur McDonald's” (fq.248). Natyrisht, këtu McDonald's përdorej si simbol i triumfit ndërkombëtar të kapitalizmit i cili, siç pretendojnë autorët e tillë, po ashtu ngërthen në vetvete një shtysë të qenësishme për paqe. Pothuajse në të njëjtën kohë me publikimin e librit të Friedman-it, NATO e kishte bombarduar Serbinë e cila veçse kishte McDonald's. Natyrisht se ky nuk ishte as shembulli

i parë e as i fundit që tregonte se të kesh McDonald's nuk është zgjidhja përfundimtare për paqe. Megjithatë, përkundër mbrojtjes së idesë që kishte vazhduar t'i bëntë Friedmani më pas, kjo ngjarje dëshmoi edhe njëherë se ka çështje për të cilat vullneti politik është i pazëvendësueshëm nga forcat ekonomike.

Një qasje e ngjashme e tipit neoliberal si ajo e Friedman-it kishte nisur në vitin 2020 si mënyrë që shtyhej për t'i zgjidhur çështjet mes Kosovës dhe Serbisë. E njëjta u materializua shpejt me 4 shtator 2020, kur administrata e Trump-it nënshkroi marrëveshja të ndara me Kryeministrin e Kosovës dhe Presidentin e Serbisë. Ndonëse përmbajtja e këtyre marrëveshjeve meriton një analizë të veçantë meqë në mënyrë të çuditshme ishin vendosur shumë çështje që nuk lidheshin njëra me tjetrën, është qasja e "dy McDonald's-ave" që duhet vënë në pikëpyetje sepse janë dy pika në kontekstin që po e trajtojmë që e bëjnë këtë qasje të kotë.

E para, ndonëse është e vërtetë që zhvillimi ekonomik luan rol kyç në formësimin e politikës së një vendi, është naivitet të besohet se bashkëpunimi ekonomik si i vetëm do t'i mbyllë përjetësisht të gjitha mosmarrëveshjet ekzistuese dhe potenciale mes dy vendeve – sidomos nëse ato janë vende fqinje. Shumë shembuj tregojnë se si t'i kesh "dy McDonald's-a" apo të keshë vëllim të madh të shkëmbimit tregtar

nuk e parandalon konfliktin, pushtimin, apo luftën – për shembull, Sh.B.A-të dhe Panama në 1989, India dhe Pakistani në 1999, Izraeli dhe Libani në 2006, Rusia dhe Gjeorgjia në 2008, Rusia në Krimë në 2014, dhe Rusia dhe Ukraina në 2022, - apo se do ta zgjidhin ndonjë konflikt apo marrëdhënie të tensionuar – për shembull, Kina dhe Tajvani, Izraeli dhe Turqia, Rusia dhe Turqia, etj. Tutje, edhe në rastet më pak ekstreme se lufta, nuk ka garancion për një korelacion të përhershëm të zhdrejtë mes nivelit të zhvillimit ekonomik dhe lindjes së tendencave malinje në politikë. Kemi shembuj të shumtë nga vendet e zhvilluara ekonomisht ku racizmi, ksenofobia, homofobia, islamofobia, dhe shumë të tilla nuk janë vetëm fobi por shndërrohen në manifestë, parti, programe, dhe aksione politike.

E dyta, si gjithnjë, konteksti është thelbësor në përcaktimin e mjeteve të zgjidhjes. E kaluara e këtyre vendeve, e cila ka qenë e përgjakshme, dhe është ende e gjallë, është e një natyre që nuk e bën çështje që mund të adresohet nga fuqitë e tregut. Çështjet e pazgjidhura mes Kosovës dhe Serbisë burojnë nga një raport kolonial që kulmoi në luftën e viteve 1998-99, gjatë së cilës Serbia kreu krime gjenocidale në Kosovë.³ Gati çdo i dhjeti i vrarë gjatë luftës është ende i pagjetur.⁴ Dhe gati çdo i dhjeti i vrarë gjatë luftës ishte fëmijë.⁵

³ Artikulli i publikuar nga The Irish Times më 14 prill 2021 citoi Presidentin e Kosovës, Znj. Vjosa Osmani, e cila tha që Kosova synon të padisë për gjenocid Serbinë.

⁴ Bazuar në një listë, publikuar nga Humanitarian Law Center në 2014, 13,517 njerëz janë vrarë ose zhdukur gjatë luftës në Kosovë. Aktualisht, rreth 1,600 akoma janë të pagjetur.

⁵ Po aty.

Vlerësohet mes 10 dhe 20 mijë gra shqiptare të jenë përdhunuar nga policia dhe ushtria serbe.⁶ Mbi 90% e popullsisë shqiptare apo rreth 1.45 milionë ishin zhvendosur.⁷ Rreth 850 mijë ishin dëbuar nga Kosova.⁸ Gati 40% e shtëpive ishin rrënuar pjesërisht ose tërësisht.⁹

Pra, tregjet janë krejtësisht të paaftha që t'i zgjidhin këto dhe çështje të ngjashme. Dhe, edhe nëse dikush e bën gabimin që krejtësisht t'i injorojë plagët nga e kaluara e afërt, problemi sot është i një natyre tejet politike dhe juridike: Kosova ka shpallur Pavarësinë nga Serbia ndërsa Kushtetuta e Serbisë ende e njeh Kosovën si pjesë të Serbisë – edhe pas kontestimit të shpalljes së Pavarësisë së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe pranimit të një verdikti të qartë mbi njohjen e së drejtës së Kosovës për pavarësi.¹⁰ Prandaj, nevojiten përgjigje politike për ta zgjidhur ketë mosmarrëveshje.

3. Bashkëpunimi rajonal ekonomik – një domosdoshmëri por realitet jo edhe aq i suksesshëm

Përderisa është e vërtetë që marrëdhëniet ekonomike nuk mund ta zëvendësojnë vullnetin politik, i cili është i nevojshëm për t'i zgjidhur

çështjet e hapura që kanë mbetur mes Kosovës dhe Serbisë, nuk duhen hudhur poshtë këto marrëdhënie si të pa dobishme. Përkundrazi, për shkak të ndërvarshmërisë globale dhe madhësisë së ekonomive rajonale, bashkëpunimi ekonomik është domosdoshmëri. Këto dy vende kanë nënshkruar rreth 33 marrëveshje bilaterale që mbulojnë fusha të ndryshme dhe kemi qenë dëshmitar të disa nismave të cilat kanë premtuar fuqizimin e bashkëpunimit rajonal ekonomik por që në fakt nuk i kanë përmbushur qëllimet e tyre.

Rasti i parë ku marrëdhëniet ekonomike mes Kosovës dhe Serbisë janë formalizuar, në një kontekst rajonal, ka qenë në 2007 kur Kosova, e përfaqësuar nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), i është bashkuar Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA). Një vit më pas, Kosova e ka shpallur Pavarësinë dhe tre nga gjashtë anëtarët tjerë të CEFTA-s ende sot nuk e njohin atë. Edhe pse të gjithë anëtarët janë zotuar për tregti të lirë, Kosova në vazhdimësi është ballafaquar me barriera jo-tarifore tregtare nga këto vende që nuk e kanë njohur Pavarësinë e saj, në veçanti nga Serbia, dhe në mënyrë sporadike Kosova iu është përgjigjur me barriera tarifore dhe jo-tarifore.

⁶ Shiko "The Kosovo Refugee Crisis: An Independent Evaluation of UNHCR's Emergency preparedness and Response" publikuar nga UNHCR Standing Committee më 9 shkurt 2000.

⁹ Po aty.

¹⁰ Shiko Opinioni Këshillues i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë "Pajtimi me të drejtën ndërkombëtare të deklaratës të pavarësisë unilaterale sa i përket Kosovës" publikuar më 22 korrik, 2010.

Rasti i dytë që kishte potencial për t'i përmirësuar raportet ekonomike ka të bëjë me procesin e integritimit në Bashkimin Evropian (BE). Së pari, ishte Marrëveshja për Stabilizim Asociim (MSA) mes Serbisë dhe BE-së në vitin 2013, dhe MSA-ja mes Kosovës dhe BE-së në vitin 2016. Edhe liberalizimi i tregut, edhe bashkëpunimi rajonal janë elemente kyçe të MSA-së. Së dyti, ishte Procesi i Berlinit që filloi në vitin 2014 për t'u vazhduar nga disa mbledhje ndër-qeveritare që synonin forcimin e marrëdhënieve të vendeve brenda Ballkanit Perëndimor dhe mes tyre dhe shteteve të BE-së. Deri tani, asnjëra nga këto nisma nuk ka shënuar ndonjë përmirësim thelbësor në marrëdhëniet ekonomike mes Kosovës dhe Serbisë.

Nisma e tretë që nuk krahasohet me tri nismat e mëparshme, por që nuk mund të neglizhohet, është e ashtuquajtuara Mini-Schengen apo Open Balkan, që ka filluar në vitin 2019 në një takim të mbajtur në Novi Sad ku Presidenti i Serbisë ka ftuar Kryeministrat e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut. Përderisa një ide e tillë mund të ketë ekzistuar edhe më herët, përpjekjet e këtyre tre liderëve politikë kanë një numër mangësish serioze që në mënyrë drastike i zvogëlojnë gjasat që kjo nismë të shndërrohet në një nismë të suksesshme të bashkëpunimit rajonal ekonomik.

Së pari, përderisa termi "Balkan" është në emrin e saj, si një cilësi gjithëpërfshirëse e vendeve që synojnë t'i bashkohet BE-së, tri vende të

Ballkanit Perëndimor – Kosova, Mali i Zi, dhe Bosnja dhe Hercegovina, nuk janë pjesë e kësaj nisme. Edhe nëse Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina i bashkohen kësaj nisme, meqë kanë dhënë sinjale ditëve të fundit, Kosova nuk duket se do t'i bashkohet me ç'rast e bën nismën përjashtuese. Së dyti, kjo nismë duket se e imiton Procesin e Berlinit, por nuk arrin në nivelin e tij sepse nuk e ka një platformë të shkruar ku qëllimet, strategjitë, platformat, mekanizmat, dhe zotimet buxhetore janë të definuara mirë. Së treti, qëllimi që pretendohet se e ka nuk dallon shumë nga nismat paraprake. Themeluesit e saj pretendojnë se vizioni kryesor i kësaj nisme përbëhet nga liria e lëvizjes së njerëzve, mallrave, shërbimeve, dhe kapitalit.¹¹ Mirëpo, kjo është saktësisht çfarë CEFTA, MSA-ja, dhe sidomos Tregu i Përbashkët Rajonal, si derivat i Procesit të Berlinit, po ashtu kanë për qëllim. Përderisa një kundër-argument këtu mund të ishte se kjo nismë është pikërisht për t'i adresuar dështimet nga nismat e kaluara, s'do të ishte aspak bindës për shkak të dy argumenteve të mëhershme – që është nismë përjashtuese dhe që i mungon një plan i shkruar me zotime që mbështeten nga financat. Dhe, së katërti, ndonëse e imiton Procesin e Berlinit, është pretenduar se kjo nismë ka nisur nga pakënaqësia me qasjen që BE-ja ka pasur karshi rajonit.¹² Për aq kohë sa të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor synojnë të integrohen në BE, projekte të tilla munden vetëm të krijojnë fërkime të panevojshme dhe të shkaktojnë vonesa të mëtejme në procesin e integritimit. Prandaj, deri tani, kjo nismë ka qenë më shumë përçarëse sesa përbashkuese për rajonin.

¹¹ Shiko "Eine Perspektive für den Balkan" me autorë Edi Rama, Aleksander Vucic, and Zoran Zaev, publikuar nga Frankfurter Allgemeine më 21 dhjetor 2021.

¹² Po aty.

4. Perspektiva për t'i përmirësuar rezultatet

Mangësitë e nismave të mëhershme nuk duhet t'i dekurajojnë përpjekjet në të ardhmen. E as nuk duhet lejuar që projektet përçarëse si Mini-Shengen/ Open Balkan t'i anatemojnë potencialet e bashkëpunimit ekonomik në rajon në nivelin bilateral apo multilateral. Megjithatë bashkëpunimet e tilla duhen mirëmbajtur vazhdimisht dhe mënyra e vetme racionale për të krijuar një shtysë për këtë mirëmbajtje është përmes nismave me përfitim reciprok. Natyrisht, nisma të tilla kërkojnë racionalitet nga liderët politikë dhe përqëndrim në përfitimet socio-ekonomike për shumicën.

4.1 Një zhvendosje paradigmatisht nga *barazia në mundësi në drejtësi*


Në mënyrë që secila nismë për bashkëpunim ekonomik të jetë njëmend e suksesshme duhet të përfshijë incentiva që krijojnë përpjekje nga të gjitha palët për të arritur rezultatet më të mira. Me fjalë të tjera, nisma duhet edhe të jetë me përfitim reciprok edhe t'i marrë parasysh dallimet ekzistuese në rrafshin ekonomik. Për shembull, nisma të tilla duhet t'i marrin parasysh

pabarazitë që ekzistojnë mes dy vendeve. Me një Bruto Produkt Vendor (BPV), me çmime konstante, mbi gjashtë herë më të madh dhe me një popullsi gati katër herë më të madhe, Serbia ka një përparësi të theksuar, e cila ka edhe një dimension historik që nuk mund të neglizhohet.

Grafiku 1 më poshtë paraqet përqindjen e të ardhurave mesatare në Kosovë dhe Serbi krahasuar me të ardhurat mesatare në ish-Jugosllavi në periudhën mes 1952 dhe 1990.¹³ Vrojtimi i parë këtu është që të ardhurat mesatare të një qytetari në Kosovë kanë qenë shumë më të ulëta dhe në rënie krahasuar me të ardhurat mesatare të një qytetari në ish-Jugosllavi. Konkretisht, një qytetar në Kosovë, mesatarisht, ka patur vetëm rreth një të tretën e të ardhurave të një qytetari të ish-Jugosllavisë gjatë kësaj periudhe. Për Serbinë, në anën tjetër, qëndron e kundërta. Të ardhurat mesatare të një qytetari në Serbi, gjatë shumicës së periudhës, kanë qenë mbi të ardhurat mesatare të një qytetari të ish-Jugosllavisë dhe kanë pasur një trend në ngritje. Mesatarisht, një qytetar në Serbi ka patur të ardhura 5% më të larta se të ardhurat mesatare të një qytetari në ish-Jugosllavi.

¹³ Këtu të hyrat janë definuar si BPV për kokë banori shprehur në dollarë ndërkombëtarë të 1990-s.

Grafiku 1. Përqindja e të ardhurave mesatare në ish-Jugosllavi, 1952-1990




Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në vlerësimet e Milanovic (2011) për Projektin Maddison.

Prej 90-ave tutje, pabarazia mes dy vendeve ka qëndruar. Grafiku 2 paraqet raportin e të ardhurave mesatare në Serbi me të ardhurat mesatare në Kosovë.¹⁴ Mes 1990 dhe 2020, raporti mesatar ka qenë 1.7. Kjo do të thotë që, mesatarisht, një qytetar

në Serbi ka pasur të ardhura 70% më të larta se një qytetar në Kosovë. Këto dhe shifra të ngjashme shpërfaqin pabarazitë në kapacitetet ekonomike mes dy vendeve, e të cilat nuk duhen neglizhuar.

Grafiku 2. Raporti i të ardhurave mesatare në Serbi me të ardhurat mesatare në Kosovë



Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në UNdata.

¹⁴ Këtu të hyrat janë definuar si BPV për kokë banori në dollarë amerikanë në çmime aktuale.


Për shkak të dallimeve të tilla, çfarëdo nisme për bashkëpunim ekonomik mes dy vendeve apo në nivel rajonal duhet ta synojë drejtësinë në vend të barazive në mundësi. Kjo për faktin që, për shkak të fillimeve të pabarabarta, mundësitë e barabarta ka gjasë të prodhojnë sërish rezultate të pabarabarta. Kjo është pikërisht njëra nga arsytet pse marrëveshjet si MSA-ja implementojnë liberalizim të tregut në mënyrë asimetrike. Për shembull, përderisa BE-ja veçse i ka eliminuar pothuajse të gjitha tarifatat për importet e Kosovës, Kosovës i është dhënë një periudhë 10 vjeçare që në mënyrë graduale t'i eliminojë tarifatat për importet nga BE-ja. "Asimetri" të ngjashme apo masa afirmative duhet të bëhen pjesë e nismave të ardhshme për bashkëpunim ekonomik në nivelin bilateral apo rajonal në mënyrë që jo vetëm të adresohen pabarazitë historike por edhe si shenjë e vullnetit të mirë dhe qëllimeve të njëmendta që rajoni të përparojë.

4.2 Një zhvendosje paradigmatike nga tregtia e lirë në tregti fer

Pa asnjë përjashtim, të gjitha nismat e diskutuara më herët janë përqëndruar shumë në aspektet e liberalizimit të tregut, domethënë në heqjen e barrierave tregtare. Natyrisht, nëse bëhet në mënyrën e duhur, tregtia e lirë mund të sjellë përfitime të dyanshme për partnerët tregtarë. Mirëpo, ky nuk ka qenë rasti mes Kosovës dhe Serbisë.

Grafiku 3 më poshtë paraqet bilancin tregtar në mallra të Kosovës me Serbinë, i cili është një deficit mesatar prej mbi 231 milionë eurove mes vitit 2003 dhe 2021. Viti i vetëm kur Kosova ka pasur bilanc pozitiv tregtar ka qenë në 2019-ën kur ajo fillimisht kishte vendosur një tarifë prej 10% e më pas prej 100% për importet nga Serbia. Në vitin 2020 tarifa ishte larguar për tu zëvendësuar nga masat e pjesshme të reciprocitetit tregtar, por të cilat shpejt ishin larguar dhe kanë pasur një efekt më të vogël në zvogëlimin e deficitit tregtar. Këtu mund të vërehet edhe se si as CEFTA e as MSA-ja nuk e kanë përmirësuar deficitin tregtar, por tarifa në importe, që konsiderohet si barrierë tregtare, e ka përmirësuar atë.

Grafiku 3. Bilanci tregtar në mallra i Kosovës me Serbinë, 2003-2021 (në milion)



Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës.

Mësimi që duhet nxjerrë nga ky vrojtim nuk është aprovimi i më shumë barrierave tregtare. Masat e reciprocitetit në formë tarifore apo jo-tarifore të vendosura nga Kosova kanë qenë përgjigje ndaj barrierave jo-tarifore të vendosura nga Serbia ndaj importeve të Kosovës – një pengesë e vazhdueshme e tregtisë që nuk është zgjidhur asnjëherë as nga autoritetet e CEFTA-s. Këto masa janë ashpërsuar edhe më shumë që nga 2008, e që kishin të bënin me faktin se Kosova shpalli Pavarësinë në këtë vit. Nga kjo mund të kuptojmë se tregtia nuk ka qenë vërtetë e liberalizuar dhe se skenari ideal këtu do të ishte sikur t’iu qëndronin besnike parimeve të tregtisë së lirë. Kjo do të thotë se Serbia do të hiqte dorë nga barrierat jo-tarifore ndaj importeve të Kosovës dhe, në këtë

mënyrë, Kosova nuk do të kishte nevojë të kundërvihej me masa reciproke.

Megjithatë, edhe sikur tregtia mes dy vendeve të ishte njëmend e lirë, kjo nuk do të ishte e mjaftueshme. Jo vetëm për shkak të deficiteve tregtare në nivelin makro apo humbjeve që mund të krijoheshin nga vendet e vogla. Por sepse tregtia e lirë si e tillë nuk i adreson çështjet si pagat e punëtorëve apo kushtet e punës, çmimet fer të prodhuesve të vegjël industrial apo fermerëve, apo gjendjen e ambientit. Fituesit e parë dhe të menjëhershëm të tregtisë së lirë janë në fakt prodhuesit e mëdhenj dhe kompanitë tregtare. Rrjedhimisht, një zhvendosje paradigmatisht, një zhvendosje zhvendosje nga ngarendja pas veç tregtisë së lirë, domethënë eliminimit të të gjitha barrierave tregtare qofshin

ato tarifore apo jo-tarifore, në një angazhim më të madh për tregti fer – e cila ngërthen në vete tregtinë e lirë por me një përqëndrim më të madh në drejtësi karshi pagave të punëtorëve dhe kushteve të punës, fitimeve të prodhuesve dhe fermerëve të vegjël, dhe zvogëlimit të eksternaliteteve negative që vazhdojnë ta përkeqësojnë ambientin.

4.3 Një përqëndrim intensiv në progresin brenda vendit i cili reflekton në progresin mes vendeve

Siç edhe ndodh në marrëdhëniet ndërkombëtare, ku zhvillimet e brendshme reflektojnë në marrëdhëniet e jashtme, një logjikë e përafërt ngjan edhe në sferën ekonomike. Agjendat e brendshme ekonomike janë thelbësore për bashkëpunimet e jashtme. Nga një perspektivë progresiste, për shembull, pabarazia ekonomike është një çështje kyçe që duhet adresuar nga cilado qeveri progresiste. Përderisa më parë e pamë pabarazinë ekonomike mes dy vendeve, ekziston një pabarazi ekonomike mjaft e lartë edhe brenda këtyre vendeve. Për shembull, 10%-shi më i pasur i popullsisë në Kosovë dhe Serbi zotëron gati një të tretën e të ardhurave të secilit vend, ndërsa 50%-shi më i varfër i popullsisë zotëron më pak se një të pestën e të ardhurave në secilin vend.¹⁵

Siç është rasti edhe në vendet tjera, pabarazia në pasuri është edhe më e rëndë.¹⁶ Të dhënat për Kosovën mungojnë, por 10%-shi më i pasur në Serbi zotëron 55% të pasurisë së vendit, gjersa 50%-shi më i varfër zotëron vetëm rreth 6% të pasurisë së vendit.¹⁷ Më shumë demokraci ekonomike, kushte më të mira të punës, sindikata më të forta, legjislaturë më e rreptë kundër oligarkisë, etj., janë disa nga përbërësit që mund ta ndihmojnë formësimin e institucioneve më progresiste që edhe i adresojnë këto pabarazi të brendshme, edhe kanë më shumë vullnet për t'i përmirësuar marrëdhëniet fqinjësore. Kështu, bashkëpunimi ekonomik në nivelin bilateral apo rajonal do të mund të kishte më shumë gjasa që të kishte sukses meqë do të ndërtohej brenda këtyre konturave progresiste që do të reflektonin nga progresi i brendshëm.

5. Përfundim

Përderisa zhvillimi ekonomik mbetet thelbësor në adresimin e shumë çështjeve brenda një vendi, ka kufizime në atë se çfarë mund të arrihet përmes nismave për bashkëpunim ekonomik në nivelin bilateral apo rajonal. Çështja kryesore e pazgjidhur mes Kosovës dhe Serbisë është e një natyre politike për të cilën tregjet nuk kanë fuqi ta zgjidhin. Megjithatë, marrë parasysh madhësinë dhe nivelin e zhvillimit të ekonomive respektive, është e qartë që bashkëpunimi rajonal ekonomik është domosdoshmëri – edhe pse ky nuk do t'i zgjidhë çështjet kryesore politike. Por, shumë mangësi nga nismat e deritanishme lënë të kuptojnë se paradigmat aktuale nuk kanë prodhuar rezultatet e dëshiruara. Për këtë arsye,

¹⁵ Shiko World Inequality Database.

¹⁶ Po aty.

¹⁷ Po aty.

nëse ka vullnet serioz politik, një zhvendosje paradigmатike nga *barazia e mundësive në drejtësi* dhe nga tregtia e lirë në tregti *fer*, dhe një përqëndrim intensiv në zhvillim të *brendshëm*, do të mund t'i vendosnin konturat e duhura

ku nismat aktuale, si Tegu i Përbashkët Rajonale nga Procesi i Berlinit, apo edhe nisma të reja të bashkëpunimit rajonal ekonomik do të mund të prodhonin rezultate më të suksesshme.

Bibliografia

Friedman, T. L. (1999). *The Lexus and the Olive Tree: Understanding Globalization*. New York: Farrar, Straus & Giroux.

Kant, I. (1795). Perpetual peace: A philosophical sketch. In H. Reiss (ed.), *Kant: Political Writings* (pp. 93-130). Cambridge: Cambridge University Press.

KAS. (2022). *ASKdata*. Retrieved from Kosova Agency of Statistics (KAS).

Milanovic, B. (2011). *Estimates provided to the Maddison-Project*. Retrieved from <https://www.rug.nl/ggdc/historicaldevelopment/maddison/releases/maddison-project-database-2013>

United Nations. (2022). *Per capita GDP at current prices - US dollars*. Retrieved from UNdata: <http://data.un.org/Data>.

KUFIZIMET DHE PERSPEKTIVA E MARRËDHËNIEVE EKONOMIKE NDËRMJET REPUBLIKËS SË KOSOVËS DHE SERBISË



Forcat ekonomike vetëm nuk mund ta bëjnë atë që vullneti politik nuk do ta bëjë



Ndonëse është e vërtetë që marrëdhëniet ekonomike nuk mund ta zëvendësojnë vullnetin politik, i cili është i nevojshëm për t'i zgjidhur çështjet që kanë mbetur hapur mes dy vendeve, marrëdhëniet ekonomike nuk duhet hudhur poshtë si të papërdorshme



Një përqëndrim intensiv në progresin *brenda* vendit i cili reflekton në progresin *mes* vendeve, i ndërtuar në progresizëm ekonomik, përbën një platformë ku shanset për sukses janë më të mëdha



Një zhvendosje paradigmatiske nga *barazia në mundësi në drejtësi* dhe nga tregtia e *lirë* në tregtinë *fer* mund të hapë horizonte për nisma më të suksesshme të bashkëpunimit ekonomik në të ardhmen